

V E N D I M
Nr. 479, datë 31.8.2000

**PËR PËRGATITJEN DHE REALIZIMIN E KONTRATËS SË KONCENSIONIT,
PËR NDËRTIMIN E TERMINALIT TË RI TË PASAGJERËVE, NË AEROPORTIN
E RINASIT**

(Ndryshuar me VKM nr. 562, datë 23.10.2000; nr. 603, datë 2.11.2001; nr. 526, datë 31.10.2002)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995, “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, të neneve 21 dhe 29, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 7, të ligjit nr.8554, datë 10.12.1999, “Për buxhetin e shtetit të vitit 2000”, të ligjit nr.7638, datë 11.11.1992, “Për shoqërinë tregtare”, dhe të neneve 5, 17, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995, “Për prokurimin publik”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe të ministrit të Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Fillimin e procedurës së tenderimit, për ndërtimin e terminalit të ri të pasagjerëve në aeroportin e Rinasit, me koncesion të formës BOOT.

Objekt i koncesionit të jenë edhe elementët e tjerë infrastrukturorë, shërbimet aeroportuale dhe joaeroportuale, sipas përcaktimit të masterplanit të zhvillimit të Aeroportit Ndërkombëtar të Rinasit.

2. Procedura e përzgjedhjes së investitorit të jetë tenderi i hapur, ndërkombëtar, me dy faza (faza e parë: parakualifikimi).

Procedurat për kriteret e përzgjedhjes së investitorit për fazën e parë (parakualifikimi) përcaktohen sipas aneksit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Organi shtetëror i autorizuar (OSHA) të nxjerrë urdhrin përkatës për fillimin e procedurave të publikimit të shprehjes së interesit.

3. Realizimi i procedurave për ndërtimin e terminalit të ri të pasagjerëve dhe elementëve të tjerë infrastrukturorë, shërbimeve aeroportuale dhe joaeroportuale në aeroportin e Rinasit, me koncesion të formës BOOT, të bëhet me konsulencë ndërkombëtare.

4. Lejohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit në emër të OSHA të prokurojnë fondin limit prej 43 500 000 (dyzetetë milionë e pesëqind mijë) lekësh, me procedurën “Kërkesë për kuotim”, me shoqëritë konsulente, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Fondi prej 43 500 000 lekësh të përballohet nga fitimi i pritshëm për vitin 2000 i “Albtransport” sh.a.

6. Shfuqizuar.

7. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Transportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

LISTA E SHOQËRIVE KONSULENTE

ABM AMRO
BANCA D'INTERNAZIONALE MOBILIARE (IMI)
CREDITANSALT INVESTMENT BANK
CREDIT SUISSE FIRST BOSTON
LAZARD VITALE BORGHESI&C
MORGAN STANLEY
NATIONAL BANK OF GREECE
SBC BARBURG DILLON REED
DELOITTE&TOUCHE
PRICE WATERHOUSE COOPERS
ERSA-ERILBUR SMITH ASSOCIATES
EUROPEAN INVESTMENT BANK

ANEKS

(Shtuar me VKM nr. 526, datë 31.10.2002)

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË INVESTITORËVE STRATEGJIKË TË INTERESUAR PËR KONTRATËN E KONCESIONIT PËR NDËRTIMIN E TERMINALIT TË RI TË PASAGJERËVE NË AEROPORTIN E RINASIT

I. Midis investorëve që do të kenë dërguar shprehjen e interesit, duke përmbushur kërkesat e treguara në njoftimin publik të publikuar në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 329, datë 12.7.1999 “Për procedurat e tenderimit për zgjedhjen e investorëve strategjikë dhe transferimin e aksioneve të zotëruara nga shteti në shoqëritë tregtare të sektorëve me rëndësi të veçantë”, ftesa për tender do t'i dërgohet vetëm kandidatëve që përmbushin kërkesat e parashikuara në pikën II të këtij urdhri, sipas afateve të parashikuara në të.

II. Investorët strategjikë të interesuar, që do të ftohen të paraqesin ofertat e tyre më të hollësishme të detyrueshme, duhet të përmbushin vetëm kërkesat e mëposhtme paraprake:

II.1. Të jenë shoqëri aksionere ose persona juridikë të ngjashëm sipas legjislacionit të vendit ku ata janë krijuar, të jenë të krijuara dhe të regjistruara tek autoritetet kompetente ku ndodhet selia.

II.1.1. Do të pranohen edhe konsorciume të përbëra nga shoqëri aksionere apo persona juridikë të ngjashëm.

II.1.2. Do të pranohen dhe kombinimet e investorëve që veprojnë së bashku si konsorcium për qëllimet e këtij koncesioni apo që synojnë të kryejnë transaksionin nëpërmjet një shoqërie që do të krijohet (“Shoqëria e Re”).

II.1.3. Në rastin e kombinimit të investorëve strategjikë me investorët financiarë, investitori strategjik duhet të ketë kontrollin e aksioneve.

Angazhimi i subjekteve ndërtuese shqiptare në këto konsorciume do të jetë kusht favorizues për ofertat e investorëve të interesuar.

Palët të cilat janë në likuidim apo nuk kanë aftësi paguese janë nën administrim apo procedime të tjera të ngjashme, apo ndonjë procedim që nënkupton një mosaftësi paguese apo ndërprerje të biznesit, nuk do të pranohen në procedurën e tenderit.

II.2. Në aktivitetin aeroportual të shoqërisë të përfshihet kapaciteti i Turnover-it vjetor jo më pak se 250 000 000 (dyqind e pesëdhjetë milion) euro mesatarisht për tre vitet e fundit, deri me 31 dhjetor 2001.